



Planuar / Doretuar Planned/Ordered Received/Delivered	25.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMB/HK	1612/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.116/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.116/2022 të datës 11.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.116/2022 e datës 11.02.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. Shfuqizohet Vendimi i datës 13.01.2022 përmes të cilit ankuesit si ne piken 1 të këtij vendimi i është shqiptuar masa disiplinore “Vërejtje”.
- III. Obligohet Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës të zbatoj këtë vendim brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Zyrtarë Korrektuesë” në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë/Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datë 11.02.2022 ka parashtruar ankesën me numer protokolli 685/2022 të regjistruar me numër A.nr.116/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 13.01.2022 të nxjerrë nga Mbikëqyrës i lartë në Shërbimin Korrektues të Kosovës permes te cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore “Vërejtje”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 16.02.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje të institucioni përkatës, Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa me datën 28.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore administroi këto prova: Ankesën me numer protokolli 685/2022 të regjistruar me numër A.nr.116/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 13.01.2022 me të cilin ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje"; Përgjigjen në ankesë të datës 28.02.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 1038 së bashku me provat e lëndës faqe 1/17: Kontratën e datës 20.08.2020; Kontraten e punës të datës 01.02.2018; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës të datës 23.05.2018 dhe Përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedure është konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë – Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Me datë 13.01.2022 mbikëqyrësi i lartë njeherit mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit ka nxjerr vendim përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me arsyetimin se drejtori i institucionit gjatë vizitës në shëtitore me datë 11.01.2022 rreth orës 13:15 ka verifikuar se zyrtari në fjalë nuk ishte në mbikëqyrjen e lëvizjeve të burgosurve në shëtitore por ishte duke biseduar me zyrtarin tjetër korrektues të caktuar në shëtitore dhe me këtë veprim ankuesi ka shkelur detyrat e përcaktuara sipas përshkrimit të vendit të punës ku thuhet se "Mbikëqyrë të gjitha lëvizjet e të burgosurve në shëtitore".

Kundër vendimit të datës 13.01.2022 për shqiptimin e masës disiplinore ankuesi ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se me datë 11.01.2022 ka qenë në vendin e punës së bashku me kolegun duke i përcjell lëvizjet e të burgosurve në anën e djathtë të shëtitores ndërsa kolegu në anën e majte të shëtitore. Rrjedhimisht ankuesi pretendon se nuk ka bërë shkelje të detyrave të punës sepse ka qenë në përcjellje të burgosurve, mirëpo sipas të njëjtit drejtori i institucionit ka shikuar nga pavijoni dhe ka menduar se jemi duke biseduar me kolegun dhe ka urdhëruar udhëheqësin për shqiptimin e masës disiplinore. Me tutje ankuesi pretendon se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i cili ka shqiptuar masën disiplinore nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe nuk ka pasur mundësi me ditë çka ka ndodhur, dhe konsideron se masa disiplinore është shqiptuar në kundërshtim me rregulloren.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit analizoj dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenin 46 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. nuungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4.



kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar, dhe nenin 45 paragrafi 1 të këtij ligji ku përcaktohet se: 1 Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, dhe rrjedhimisht konstatoi se me dispozitat nenin 46 paragrafi 4 janë përcaktuar në mënyrë taksative shkeljet e lehta disiplinore, ndërsa me nenin 45 janë përcaktuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të cilat duhet të plotësohen në mënyrë komulative për tu konsideruar nëpunësi civil përgjegjës për shkelje disiplinore.

Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji shqyrtoje Vendimin e datës 13.01.2022 përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore e vërejtjes dhe si rrjedhojë gjeti se masa disiplinore ndaj ankuesit është shqiptuar me arsyetimin se ankuesi me datë 11.01.2022 rreth orës 13:15 nuk kishte në mbikëqyrje lëvizjen e të burgosurve në shëtitore por ishte duke biseduar me zyrtarin tjetër korrektues të caktuar në shëtitore.

Kolegji vlerëson se arsyetimi i vendimit të kontestuar është i mangët dhe i pamjaftueshëm dhe si i tillë nuk mbështetet në prova bindëse përmes të cilave mund të vërtetohet shkelja e supozuar e detyrave të punës nga ankuesi, gjegjësisht nuk mund të vërtetohet me asnjë provë materiale se ankuesi nuk ka qenë duke ushtruar detyrën apo nuk ka qenë duke mbikëqyrë lëvizjen e të burgosurve me datë 11.01.2022. Në kërkesën e datës 16.02.2022 drejtuar organit të punësimit Kolegji kishte kërkuar të gjitha provat që mbështesin masën disiplinore mirëpo gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës nuk gjeti ndonjë provë që mbështet pretendimin e drejtorit të institucionit se ankuesi me datë 11.01.2022 rreth orës 13:15 nuk kishte në mbikëqyrje lëvizjen e të burgosurve dhe rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës të dërguara nga organi i punësimit nuk mund të vërtetohet se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës.

Kolegji, në kuadër të shkresave të lëndës ka gjetur Raportin e datës 12.01.2022 të cilën e ka përgatitur dhe nënshkruar vetë mbikëqyrësi i ankuesit i cili edhe ka shqiptuar masën disiplinore ndaj ankuesit, mirëpo sipas këtij raporti shihet se mbikëqyrësi nuk ka qenë në vendin e ngjarjes por vetëm e përshkruan situatën ashtu siç pretendon se ka ndodhur ngjarja drejtori i institucionit, e i cili raport nuk mbështetet në asnjë provë materiale.

Andaj, bazuar si me lartë Kolegji konstaton se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore nuk ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material sepse nuk është plotësuar asnjë nga elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se vërejtja e 13.01.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, duhet të fshihet nga dosja personale dhe regjistri përkatës në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 51 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kështu që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për



Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.116/2022, datë 25.03.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

